



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

## RREGULLORE

### **“PËR VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR PËRFITIMIN E KREDISË SË LEHTËSUAR PËR STREHIM PËR KATEGORINË “TË PUNËSUAR NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”, PËR VITIN 2024”**

#### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe hapave proceduralë që do të ndjekë Komisioni përgjegjës për vlerësimin e kërkesave për përfitimin e kredisë së lehtësuar për strehim, për kategoritë të punësuar në administratën publike, për vitin 2024.

##### **Neni 2 Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 468, datë 26.7.2023 “Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 400, datë 24.06.2024 “Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike”, Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 374, datë 09.07.2024 “Për ngritjen e komisionit përgjegjës për ndjekjen e procedurës dhe vlerësimin e kërkesave për përfitimin e kredisë së lehtësuar për strehim, për kategorinë “të punësuar në administratën publike”, për vitin 2024.

##### **Neni 3 Përkufizime**

Të gjithë termat e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimin e dhënë në Ligjin Nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 468, datë 26.7.2023 “Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 400, datë 24.06.2024 “Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike”, Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 374, datë 09.07.2024.

## **KREU II**

### **PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KËRKESAVE PËR PËRFITIMIN E KREDISË SË LEHTËSUAR PËR STREHIM PËR KATEGORINË “TË PUNËSUAR NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”, PËR VITIN 2024”**

#### **Neni 4**

##### **Vlerësimi paraprak**

1. Pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor për paraqitjen e kërkesave në portalin on line e – Albania, Komisioni mblidhet dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve pune shqyrton kërkesat e paraqitura.
2. Komisioni harton një procesverbal me të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e dorëzuar nga kërkuesit duke evidentuar mangësitë në dokumentacion. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.
3. Bazuar në procesverbalin e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, kërkuesit të cilët kanë mangësi në kërkesë njoftohen nëpërmjet portalit e- Albania brenda një afati 5 (pesë) ditor. Njoftimi përcakton qartë dokumentacionin mungues dhe njoftimin se kërkuesit duhet të marrin masa për plotësimin e mangësive të tij brenda një afati 5-ditor (pesë) ditor.
4. Në rast mosplotësimi të mangësive brenda afatit 5 (pesë) ditor, kërkesa i kthehet kërkuesit nëpërmjet portalit “e-Albania”.
5. Pas kalimit të afatit 5-ditor (pesë) ditor të pritjes së plotësimin të dokumentacionit, Komisioni harton një procesverbal lidhur me kërkuesit të cilët kanë plotësuar kërkesat dhe vijon shqyrtimin e tyre për të përcaktuar pikëzimin e kërkuesve sipas kritereve ligjore në fuqi.

#### **Neni 5**

##### **Pikëzimi i kërkuesve**

1. Komisioni shqyrton kërkesat e ardhura, brenda 10 (dhjetë) ditëve duke u bazuar në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në Shtojcën 1, të kësaj Rregullore. Renditja e kandidatëve bëhet sipas pikëve të marra ku prioritet kanë mjekët dhe infermierët në institucionet e kujdesit shëndetësor publik. Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara pas plotësimin të dokumentacionit dhe vlerësimin të tij, përzgjedhja do të bëhet sipas një sistemi pikëzimi të hartuar nga komisioni të përcaktuar në Shtojcën nr. 2, të kësaj Rregullore . Në rast se edhe pas pikëzimit të hartuar nga komisioni ka ende kërkues me pikë

të barabarta, përzgjedhja bëhet me short të përcaktuar nga institucioni, në prani të të gjithë anëtarëve duke siguruar edhe filmimin e procesit.

2. Komisioni pas përfundimit të procesit të pikëzimit sipas pikës 1, të këtij neni mban një procesverbal të detajuar për këtë proces dhe përgatit listën paraprake të përfituesve. Në rast se numri i fituesëve nga lista e fituesëve nga kategoritë prioritare mjekë dhe infermierë në institucionet e kujdesit shëndetësor publik, është më e vogël se kuatat e miratuara për MSHMS atëherë kuatat plotësohen me kandidatët e tjerë në listë sipar renditjes së pikëzimit.
3. Kërkuesit fitues ose jofitues njoftohen nëpërmjet portalit “e-Albania”, brenda 5 (pesë) ditëve nga përgatitja e listës paraprake.

## **Neni 6 Ankimi**

1. Kërkuesit kanë të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

## **Neni 7 Shpallja e fituesve**

1. Pas përfundimit të procesit të ankimit sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, Komisioni përgatit listën e përfituesve dhe ia përcjell për miratim Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Komisioni, pas miratimit të listës nga Ministri, publikon listën e përfituesve në portalin “e-Albania” dhe në faqen zyrtare të tij.
3. Lista përfundimtare e përfituesve përcillet me shkrim pranë Entit Kombëtar të Banesave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

## **KREU III**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe është e vlefshme deri në përfundim të vitit ushtrimor 2024.

**SHTOJCA 1: KRITERET E PIKËZIMIT**

	<b>KRITERET E PIKËZIMIT</b>	<b>100 pikë</b>
<b>1.1</b>	<b>KUSHTET E STREHIMIT</b>	<b>50</b>
A.	Nuk disponojnë banesë në pronësi.	<b>50</b>
B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	<b>0</b>
C.	Punonjës, që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	<b>0</b>
D.	Punonjës, që banon në banesë që do të priset pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	<b>0</b>
<b>1.2</b>	<b>KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI/</b>	<b>25</b>
A.	Punonjës, që ka jo më pak se dy vjet i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	<b>0</b>
B.	Punonjës, që ka jo më pak se shtatë vjet i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	<b>0</b>
C.	Punonjës, që i përket kategorisë “familje e re”, në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	<b>10</b>
Ç.	Punonjës, që i përket kategorisë “të rinj me moshë jo më të madhe se 40 vjeç”	<b>10</b>
D.	Familje një prindërore, që ka në ngarkim fëmijë	<b>5</b>
<b>1.3</b>	<b>KUSHTET EKONOMIKE</b>	<b>25</b>
A.	I përket kategorisë së pagës, sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave	<b>25</b>
B.	I përket kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1	<b>0</b>
C.	I përket kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2	<b>0</b>

**SHTOJCA 2: KRITERET E PIKËZIMIT NË RAST TË BARAZIMIT TË PIKËVE**

<b>1.1</b>	<b>KUSHTET E EDUKIMIT / ARSIMIMIT /PUNËSIMIT</b>	<b>20 pikë</b>
A.	Diplomë në mjekësi i punësuar vetëm në isntitucionet e kujdesit shëndetësor publik	<b>11</b>
B.	Diplomë në infermieri i punësuar vetëm në isntitucionet e kujdesit shëndetësor publik	<b>9</b>
<b>1.2</b>	<b>KUSHTET FAMILJARE</b>	<b>15 pikë</b>
A.	Gra kryefamiljare që ka në ngarkim fëmijë	<b>8</b>
C.	Familje me më shumë se dy fëmijë	<b>7</b>
<b>1.3</b>	<b>KUSHTET E PUNËSIMIT /KATEGORIA MJEKË DHE INFERMIERË</b>	<b>15 pikë</b>
A.	Të punësuar në spitale terciare	<b>10</b>
B.	Punonjës në spital rajonal, bashkiake, ditore	<b>3</b>
C.	Institucione të tjera shëndetësore	<b>2</b>